



K.DH.SH.II.nr.995/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Apetit” Sh.P.K, me seli në Magj: Prishtinë – Mitrovicë, km11, Komuna e Obiliqit, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat T.H. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.829/20 të datës 13.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit “Apetit” Sh.P.K, me seli në Magj: Prishtinë – Mitrovicë, km11, Komuna e Obiliqit, ndërsa **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.829/20, i datës 13.07.2021, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, Departamentit Për Çështje Fiskale-dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, është **APROVOHET** PJESËRISHT Kërkesëpadia e paditësit “Apetit” sh.p.k me seli në Magjistralen Prishtinë – Mitrovicë. **ANULOHET** PJESËRISHT Aktvendimi nr.01.3.2.2/1654,1656,1909, 2104 i datës 27.03.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë Mbetet në fuqi pjesa e Aktvendimit nr.01.3.2.2/1654,1656,1909, 2104 i datës 27.03.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, me të cilin janë refuzuar Kërkesat e paditësit për rishqyrtimin

e vendimeve R1763, R1758, R1752, R1756 dt.22.01.2020 të ZBD Prizren, R2005, R2006, R2007, R2009, R2020 dt.24.01.2020 të ZBD Prizren, R1053 dt.15.01.2020 ZBD Prizren, që kanë të bëjnë me rivlerësimin e mallit doganor. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi të nxjerr vendim ligjor sipas Kërkesave të paditësit datës 03.02.2019, 06.02.2020 dhe 10.02.2010, për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore kontestuese, që kanë të bëjnë me rivlerësimin e shpenzimeve të transportit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit “Apetit” Sh.P.K, me seli në Magjistralen Prishtinë – Mitrovicë, Komuna e Obiliqit e ushtruar kundër Aktgjykimit A.nr.829/20 i datës 13.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal. Të ndryshohen pika I, II dhe III të dispozitivit të Aktgjykimit A.nr.829/20 i datës 13.07.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal ashtu që çështja gjykohet si vijon: Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e Paditësit “Apetit” SH.P.K me seli në Magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, Komuna e Obiliqit ashtu që të anulohet në tërësi Aktvendimi nr.01.3.2.2/1654; 1656; 1909; 2104 i datës 17.03.2020 i Doganës së Kosovës, Detyrohet e Paditura Dogana e Kosovës që Paditësit Apetit Sh.P.K t’ia pranoj vlerën e transaksioneve realisht të paguara sipas Faturave përcjellëse për mallërat lëndore sipas DUD-ave R 1053 të datës 15.01.2020; R-1763; R-1758; R-1752; R-1716; R-1756 të datës 22.01.2020; R2005, R2006, R2007, R2009, R2020 dt.24.01.2020 dhe Detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që Paditësit Apetit Sh.P.K që në lidhje me mishin e importuar sipas DUD-ave R 1053 të datës 15.01.2020; R-1763; R-1758; R-1752; R-1716; R-1756 të datës 22.01.2020; R2005, R2006, R2007, R2009, R2020 dt.24.01.2020 t’ia kthej mjetet e paguara më tepër në emër të taksave doganore në vlerë prej 30,732.39 € (tridhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy euro e tridhjetë e nëntë cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë Brenda 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i

zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa e paditësit është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/1654; 1656; 1909; 2104 i datës 17.03.2020, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “Apetit” Sh.P.K, me seli në Vushtrri, për rishqyrtimin e vendimeve R-1763, R-1758, R-1752, R-1756 të datës 22.01.2020 të ZBD Prizren, R2005, R2006, R2007, R2009, R2020 dt.24.01.2020 në ZBD Prizren, dhe R-1053 të datës 15.01.2020 të ZBD Prizren si të pa bazuar. Mbetet në fuqi rivlerësimet e mallit lëndor kontestues të kryera nga Sektori i Pranimit Qendror dhe Njësia e Inspektimit Pas Zhdoganimit.

Me të cilin aktvendim, është konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror dhe Njësia e Inspektimit Pas Zhdoganimit, subjektit në procedurë, i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas deklaratës doganore të lartcekura, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së dytë neni 34.2 pika a) dhe të gjashtë të vlerësimit, neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht të dhënave të disponueshme që Dogana e Kosovës disponon.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 13.07.2021, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, ANULOHET PJESËRISHT Aktvendimi nr.01.3.2.2/1654,1656,1909, 2104 i datës 27.03.2020 i Doganës së Kosovës, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/1654; 1656; 1909; 2104 i datës 17.03.2020. Mbetet në fuqi pjesa e Aktvendimit nr.01.3.2.2/1654,1656,1909, 2104 i datës 27.03.2020 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, me të cilin janë refuzuar Kërkesat e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi të nxjerr vendim ligjor sipas Kërkesave të paditësit datës 03.02.2019, 06.02.2020 dhe 10.02.2010, për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore kontestuese, që kanë të bëjnë me rivlerësimin e shpenzimeve të transportit. Në arsyetim të aktgjykimimit ndër të tjera është

theksuar se meqenëse nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturave përcjellëse të mallit, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor nga Sektori i Pranimit Qëndror dhe Njësia e Inspektimit pas zhdoganimit, duke aplikuar metodën e 2 dhe 6 të vlerësimit neni 34 paragrafi 2 pika (a) dhe neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave përkatësisht të dhënave të transaksioneve të mallrave identike të zhdoganuara në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues, dhe të dhënat e disponueshme që disponon Dogana e Kosovës. Rivlerësimi i mallit lëndor duke u referuar në referencat e ngjashme R1820/23.01.2020, R2074/24.01.2020 dhe R2069/24.01.2020, me karakteristika identike si përshkrim i mallit, eksportues i njëjtë, shteti i origjinës i njëjtë, por me vlerë më të lart se vlera e mallit kontestues gjykata i konsideroi si prova të mjaftueshme për tu rivlerësuar malli lëndor në bazë të metodës së dytë të vlerësimit neni 34 paragrafi 2 pika (a) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L109.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor të dispozitave ligjor edhe vërtetimi jo te plot dhe te gabuar te gjendjes faktike për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate

ka ardhur si shkak i vërtetimit jo te plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor dhe në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, sepse i njëjti është marrë edhe me shkelje procedurale pasi që në rastin konkret nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ shqyrtohet dhe vlerësohet ligjshmëria e një akti administrativ përfundimtar si në këtë rast, sipas dispozitave ligjore të LKA-së, LPK-së dhe ligjeve materiale. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka lënë në fuqi pjesën e Aktvendimit nr.01.3.2.2/1654; 1656; 1909; 2104 të datës 27.03.2020 me të cilin janë refuzuar kërkesat e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve përkatësisht DUD-ave kontestues e që kanë të bëjnë me rivlerësimin e mallit doganor duke mos e vërtetuar në tërësi gjendjen faktike të dokumentacionit përcjellës që e ka shoqëruar DUD-at kontestues dhe pa bërë administrimin e të gjitha provave të propozuara si në padi nga paditësi e të cilat prova kanë qenë vendimtare lidhur me çështjen kontestuese. Kolegji i kësaj gjykate konstaton se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e që janë: transaksioni bankar i datës 06.01.2020 me të cilin shitësit në emër të shitblerjes i janë transferuar shuma e prej 43,200.00USD ka të bëjë me faturën nr.005657/2019 dhe vlera e deklaruar është e harmonizuar e shumën e paguar përmes këtij transaksioni bankar; transaksioni bankar i datës 14.01.2020 me të cilin shitësit në emër të shitblerjes i janë transferuar shuma e të hollave 274,050.00USD ka të bëjë me pagesat e porosive sipas faturës nr.004554/2019; faturës nr.004558/2019; faturës nr.004553/2019; faturën nr.004564/2019; faturës nr.004705/2019 si dhe faturën nr.004407/2019 (e cila ka të bëjë me porosi tjetër të mishit por që nuk është objekt i kësaj padie) dhe vlera e deklaruar është e harmonizuar me shumën e paguar përmes këtij transaksioni; transaksioni bankar i datës 16.01.2020 me të cilin shitësit në emër të shitblerjes i janë transferuar shuma e të hollave 91,800.00USD, ka të bëjë me faturat nr. 004599/2019 dhe faturës nr.004654/2019 e që vlera e deklaruar harmonizohet me shumën e paguar përmes këtij transaksioni bankar; transaksioni bankar i datës 17.01.2020 me të cilin shitësit në emër të shitblerjes janë transferuar shuma prej 137,700.00USD ka të bëjë me faturat nr.004641/2019, faturën nr.4629/2019 dhe faturën nr.004616/2019 e që vlerat e deklaruara janë të harmonizuara me shumën e paguar përmes këtij transaksioni bankar. Kolegji ka aprovuar si të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit-paditësit se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar

gabimisht gjendjen faktike kur arsyetimin e vendimit te atakua ka konstatuar se për te pranuar vlerën e paguar te transaksionit sipas metodës se pare te vlerësimit nenit 33 KDA-se paditësi është dashtë te dëshmoj vlerën e vërtetë te transaksionit te cilën i ka paguar shitësit, pasi pala paditëse ne procedurën e ankesës ka prezantuar transferet bankare të datës 14.01.2020 në vlerë prej 274,050.00USD, i datës 16.01.2020 në vlerë prej 91,800.00USD i datës 17.01.2020 në vlerë prej 137,700.00USD e që nuk ka qenë e mundur të bëhet harmonizimi i vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksioneve bankare që gjenden në shkresat e lëndës. Për Kolegjin e kësaj gjykate, janë te bazuara pretendimet e paditësit-ankuesit se e paditura ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike te cilën gjendje e ka konfirmuar edhe gjykata e shkalles e pare ne vendimin e ankimuar kur ka konstatuar se nuk ka qenë e mundur të bëhet harmonizimi i vlerës së deklaruar të mallit lëndor me vlerën e paguar të transaksioneve bankare, për arsye se gjykata pas shqyrtimit te shkresave te lenden ne raport me pretendimet ankimore ka gjetur se, pagesat e bëra në transaksionet që gjenden në shkresat e lëndës janë të evidentuara faturat përcjellëse për të cilat është bërë pagesa. Këto qëndrime juridike te gjykatës e shkalles e pare kolegji i kësaj gjykate nuk mund ti mbështet për arsye se, sipas provave te paraqitura nga paditësi rezulton fakti se paditësi ka paraqitur transaksionin bankar duke përshkruar edhe numrin e faturave për mallin lëndor ne pagës për mallin lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht te paguar për mallin lëndore.

Kolegji i kësaj gjykate pasi ka analizuar transaksionet bankare dhe faturat e mallit lëndor kontestues, konstaton se transferet bankare janë bërë në emër dhe llogari të eksportuesit të mallit “Copaco: Cooperativa Agroindustrial – Brazil”, ku përmes të dhënave bankare të eksportuesit të paraqitura në fatura është bërë edhe transferet bankare të datës 06.01.2020, 14.01.2020, 16.01.2020, 17.01.2020, ndërsa në përshkrimin e transfereve është shënuar numri i faturave që përfshin mallin lëndor kontestues. Ndërsa pretendimi i të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është i pa mjaftueshëm pasi që nuk është prezantuar deklarata eksportuese, nuk qëndron pasi që deklarata eksportuese nuk është dokument i cili kërkohet sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe nuk është dokument i obligueshëm sa i përket përcaktimit te vlerës se mallit lëndor, ndërsa gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka konstatuar se ka mos harmonizim mes dokumenteve përcjellëse të mallit gjykata nuk ka mundur te vërtetoj se është bere pagesa e mallit lëndor qe do te dëshmonte vlerën e transaksion t ne kuptim te nenit 33 KDA-se.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete si dhe ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka aprovuar pjesërisht si të bazuar padinë e paditësit, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa vërtetuar me prova faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgjykimi i atakuar nuk është e qarte se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur te përfundimi se padia është pjesërisht e bazuar. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të priset.

Kolegji vlerëson se në procedurën para gjykatës së shkallës së parë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, andaj kolegji vlerëson se në vështrim të neni 356 LPK-se Gjykata, me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesional të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes. Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurës kontestimore, konstatim jo të plot të gjendjes faktike tani për tani vlerësohet se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të beje eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara në atë mënyrë që nëse nuk mund të bëjë një llogaritje për harmonizimin e transaksioneve bankare me faturat, atëherë e njëjta mund të bëjë propozim që sipas detyrës zyrtare të bëjë nxerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia financiare për të konstatuar të gjitha faktet duke shqyrtuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës të dhe duke caktuar detyra të qarta për ekspertin financiar në baze të propozuesit të ekspertizës dhe për nevojat e gjykatës në mënyrë të vije deri të e vërtetimi i plot i gjendjes faktike dhe varësisht nga vërtetimi gjendje faktike të zbatohet drejta e drejta materiale.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranojë si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm. Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë,

duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë, duhet ti shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, ti eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të jetë i çartë dhe i kuptueshëm, të vendos për të gjitha kërkesat e palëve në procedurë, ti vlerësoj të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe në fund të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Andaj, Gjykata e shkallës së parë në ri procedurë duhet t'i ftoj palët dhe të hap shqyrtimin kryesor, të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjithave provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, ato që gjenden në shkresat e lëndës apo prova të tjera eventuale që do të paraqiteshin nga palët, të angazhoj ekspertin financiar për të vërtetuar saktë gjendjen faktike, lidhur me provat e prezantuara, dhe më pas në mënyrë të drejtë të zbatoj të drejtën materiale, në vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së vendimit të paditurës gjatë procedurës administrative, konform nenit 43 të LKA -së, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Sh.II.nr.995/2022 me datë 05.12.2023

**Kryetare e Kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**